



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

KUVENDI I KOSOVËS SEKRETARIA	SKUPŠTINA KOSOVA SEKRETARAT	ASSEMBLY OF KOSOVO SECRETARIAT
Nr. <u>J31413/11258/12</u>		
Dt. <u>09.11</u> 20 <u>11</u>		
Prishtinë - Pristina		

**STATUTI I AUDITIMIT TË BRENDSEHM**  
**NË KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVES**

Prishtinë, Korrik 2011

## STATUTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### PËRMBAJTJA:

1. HYRJA.....	3
2. MISIONI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	3
3. FUSHËVËPRIMI I PUNËS SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	3
4. LLOGARIDHËNIA.....	4
5. PAVARËSIA.....	5
6. PËRGJEGJËSIA.....	5
7. AUTORITETI.....	6
8. STANDARDET E PRAKTIKES SE AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	7
9. NDRYSHIMET NË STATUT.....	7
10. APROVIMI I STATUTIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	8

## HYRJE

Statuti i Auditimit të Brendshëm është përgatitur dhe përpunuar vetëm për nevoja të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përmes këtij Statuti janë definuar disa të drejta dhe përgjegjësi të përgjithshme të Auditimit të Brendshëm, të cilat janë parapare më kornizën rregullative të Auditimit të brendshëm në Republikën e Kosovës.

Roli i Auditimit të Brendshëm është që të ndihmojë mënaxhmentin e një organizate në arritjen e objektivave të saj, duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve tjera të qeverisjes.

Auditimi i brendshëm kryen auditime të rregullta në fusha të ndryshme ligjore dhe kulturore, në madhësi dhe strukture të ndryshme.

Auditimi i Brendshëm gjatë kryerjes së punëve bazohet në Ligjin mbi Auditimin e Brendshëm Nr. 03/L-128, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Rregulloren për organizimin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

## MISIONI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Misioni i Auditimit të brendshëm është që të ofroj shërbime të pavarura, objektive dhe shërbime këshillëdhënëse të dizajnuara për të shtuar vlerë dhe të përmirësojë punën në mjedisin dhe aktivitetet e organizatës. Ndihmon organizatën që të arrij objektivat e saja duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar, për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

## FUSHËVËPRIMI I PUNËS SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Fushëveprimi i Auditimit të brendshëm është që të përcaktoj nëse rrjeti i organizatës së menaxhimit të rrezikut, kontrollit, dhe proceseve të qeverisjes, ashtu siç është dizajnuar dhe paraqitur nga menaxhmenti, është adekuat dhe funksionon në atë mënyrë që të sigurojë që:

- Rreziqet të identifikohen dhe menaxhohen si duhet
- Ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes të ndodhë sipas nevojës
- Informata të mjaftueshme financiare, menaxheriale dhe operative të janë të sakta, të besueshme dhe me kohë.
- Veprimet e punonjësve të janë në pajtueshmëri me politikën, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e aplikueshme.
- Burimet të sigurohen në mënyrë ekonomike, të përdoren me efikasitet dhe të mbrohen në mënyrë adekuate.
- Të arrihen programet, planet dhe objektivat
- Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm të promovohen në procesin e kontrollit të organizatës dhe

## STATUTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

- Çështjet e rëndësishme legislative ose rregullative që kanë ndikim në organizatë të janë të pranuar dhe adresuar si duhet.

Auditimi i brendshëm përkatësisht Auditori i Brendshëm ka fushëveprim edhe në:

- Rishikimi i proceseve përfshi të gjitha departamentet- në intervale të përshtatshme kohore për të përcaktuar nëse ato në mënyrë efikase dhe efektive janë duke kryer funksionet e tyre të planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollit në pajtim me kornizën ligjore të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Rishikimi/Vlerësimin e operacioneve dhe programeve për të konstatuar nëse objektivat dhe qëllimet janë në përputhje me rezultatet e arritura nga operacionet dhe programet sipas planifikimit
- Koordinimin e aktiviteteve të tjera jashtë Administratës KRK-së përfshi Njësinë Qendrore Harmonizuese, Zyrën e Auditorit Gjeneral dhe Institucionet tjera relevante që ofrojnë shërbime sigurie dhe këshilluese.
- Përgatit, azhuron dhe përcjell te Komiteti i Auditimit planet vjetore për shqyrtim dhe miratim dhe raportet e Auditimit të brendshëm.
- Bënë “Përcjelljen e rekomandimeve” adekuate për të siguruar nëse është bërë implementimi i rekomandimeve nga menaxhmenti i Kuvendit.

## LLOGARIDHËNIA

Drejtori i Njësisë së Auditimit të brendshëm, në kryerjen e detyrave të tij/saj, do të jetë përgjegjës ndaj menaxhmentit dhe Komitetit të Auditimit, që:

- Të paraqes në baza vjetore një vlerësim mbi përshtatshmërinë dhe efikasitetin e procesit të organizatës për të kontrolluar aktivitetet e saja dhe për të menaxhuar rreziqet në fushat e caktuara tek misioni dhe fusha e veprimit
- Të raportoj çështje të rëndësishme që ndërlidhen me proceset e kontrollimit të organizatës dhe partnerëve të saj, përfshirë edhe përmirësimet potenciale të atyre proceseve dhe ofrimin e informatave për sa i përket çështjeve të tilla dhe rekomandimin e zgjidhjeve.
- Të ofroj informacione periodike mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor dhe mjaftueshmërinë e burimeve të caktuara të Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
- Të koordinojë dhe të mbikëqyr funksionet e kontrolleve tjera dhe funksioneve monitoruese (menaxhimin e rrezikut, pajtueshmërinë, sigurinë, ligjshmërinë, etikën, mjedisin, auditimin e jashtëm).



## STATUTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

### PAVARËSIA

Auditimit i Brendshëm sipas LAB Nr. 03/L-128, drejtohet nga Drejtori I Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Për t'i dhënë pavarësi njësisë së auditimit të brendshëm, personeli i tij raporton Drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, i cili vetëm për çështje administrative i raporton zyrtarit kryesor administrativ/ Sekretarit të përhershëm, dhe funksionalisht komitetit të auditimit në mënyrën e caktuar në paragrafin e mësipërm "Llogaridhënia". Si pjesë e raportit të tij/saj tek komiteti i auditimit do të përfshijë një raport të rregullt mbi personelin e auditimit të brendshëm.

### PËRGJEGJËSIA

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe stafi i saj, kanë përgjegjësinë që:

- Të hartojnë një plan fleksibil vjetor të auditimit të brendshëm duke përdorur metodologjinë adekuate që bazohet në rrezik, përfshirë çdo çështje të rrezikut apo kontrollit të identifikuar nga menaxhmenti, dhe të dorëzoj këto plane tek Komiteti i Auditimit për rishqyrtim dhe miratim jo më vonë se 31 Tetor të vitit përkatës.
- Të zbatojnë planin vjetor të auditimit, siç është miratuar, duke përfshirë edhe ndonjë detyrë apo projekt të veçantë që kërkohet nga menaxhmenti dhe Komiteti i Auditimit.
- Të kryej auditime me kërkesë vetëm nëse kërkohet nga Sekretari i Përhershëm apo edhe nga Komiteti i Auditimit.
- Të sigurojë një staf profesional të auditimit më njohuri të mjaftueshme, aftësi, përvojë dhe certifikime profesionale të mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e këtij Statuti.
- Të krijojnë një program të sigurimit të cilësisë, me anë të së cilit Drejtori I Njesisë së Auditimit të Brendshëm siguron funksionimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm.
- Të kryej shërbime këshilluese, përtej shërbimeve të sigurimit të auditimit të brendshëm, të ndihmojë menaxhmentin në arritjen e objektivave të tija. Shembujt mund të përfshijnë lehtësimin, trajnimin dhe shërbimet këshillëdhënëse.
- Të lëshoj raporte periodike për Komitetin e Auditimit dhe menaxhmentin duke bërë një përmbledhje të rezultateve të aktiviteteve të auditimit.
- Të ofroj një listë të synimeve dhe rezultateve matëse të rëndësishme për Komitetin e Auditimit.

- Të merret parasysh fushëveprimi i auditorëve të jashtëm me qëllim të ofrimit të mbulimit optimal të organizatës me një kosto të arsyeshme të përgjithshme.

## AUTORITETI

Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është i autorizuar për të drejtuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës.

- të bëjë auditime të brendshme në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet, statuti i auditimit të brendshëm, kodi i etikës dhe standardet profesionale
- të marrë, shqyrtojë dhe shfrytëzojë pa kufizim të gjitha të dhënat teknike, ekonomike, financiare si dhe informatat e dokumentet në posedim ose kontroll të subjektit të sektorit publik nën auditim;
- të kopjojë të dhënat, informatat apo dokumentet e tilla për qëllime të auditimit të brendshëm si dhe të sigurojë që kopjet në fjalë të jenë ose origjinale ose të certifikuara. Dokumentet origjinale duhet të kthehen subjektit të sektorit publik nga i cili janë marrë për shfrytëzim;
- të kërkojë nga cilido zyrtar, punonjës, këshilltar ose kontraktues i subjektit të sektorit publik nën auditim që të ofrojë dëshmi fizike, shënime dhe dëshmi gojore ose informata të tjera mbi çështjet që kanë të bëjnë me auditimin ose mbi aktivitetet që janë nën auditim;
- të ketë qasje pa pengesë në pasurinë e subjektit të sektorit publik nën auditim, dhe të verifikojë dhe vlerësojë vlerat materiale dhe monetare të subjektit të sektorit publik në pajtim me rregullat dhe legjislacionin;
- të raportojë tek menaxhmenti i lartë i SSP mbi të gjitha çështjet materiale të lidhura me kryerjen e auditimit të brendshëm dhe me rezultatet e tij.
- të marrë informata të certifikuara nga Thesari, Banka Qendrore e Kosovës dhe cilado organizatë publike apo private në lidhje me xhirollogaritë dhe/ose transaksionet aktuale ose të mbyllura që përfshijnë subjektet nën auditim mbi të cilin Njësia për Auditim të Brendshëm ka kompetenca
- të i propozojë menaxhmentit të lartë të subjektit të sektorit publik kontraktimin e personelit të ekspertëve atëherë kur kërkohen njohuri dhe aftësi të veçanta në lidhje me aktivitetet e planifikuara të auditimit të brendshëm;
- të ketë qasje në Komitetin e auditimit dhe të marrë pjesë në seancat e tij;



## STATUTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

- të përcaktojë objektivat, fushëveprimin, shpeshhtësinë, metodat dhe burimet e nevojshme për kryerjen e Auditimit të Brendshëm;
- drejtori i Auditimit të Brendshëm dhe të gjithë Auditorët e Brendshëm janë të obliguar të mbajnë në fshehtësi të gjitha informacionet që atyre u janë bërë të njohura gjatë kryerjes së auditimit të brendshëm, përveç nëse ligji kërkon ndryshe.

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe stafi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është i autorizuar që të:

- Kryejnë çfarëdo detyre operative dhe funksionale për organizatën ose partnerët e saj jashtë përshkrimit të detyrave të punës.
- Inicijoj ose miratoj transaksionet e kontabilitetit që janë jashtë Njesisë së Auditimit të Brendshëm
- Drejtoj aktivitetet e punonjësve të organizatës, që nuk janë punësuar nga Njësia e Auditimit të brendshëm, përveç deri në atë shkallë kur punonjësit e tillë janë caktuar në ekipet e auditimit si duhet, ose ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar auditorët e brendshëm.

## STANDARDET E PRAKTIKES SE AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Standardet e auditimit të brendshëm do të jenë në përputhje me Standardet për praktiken Profesionale të Auditimit të brendshëm lëshuar nga Instituti I Auditorëve të Brendshëm, dhe çdo standard dhe deklaratë lëshuar nga Njësia Qendrore Harmonizuese e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe organizata tjera të kontabilitetit dhe auditimit të brendshëm. Njësia e Auditimit të Brendshëm do t'i arrijë ose tejkalojë standardet e paraqitura të praktikës së auditimit.

## NDRYSHIMET NË STATUT

Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është përgjegjës për azhurnimin e Statutit të Auditimit të Brendshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Statuti mund të ndryshohet apo plotësohet vetëm në bazë të procedurave me të cilat është miratuar.

STATUTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM


APROVIMI I STATUTIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Që Statuti i Auditimit të Brendshëm të ketë fuqi ekzekutive dhe të zbatohet në vitet në vazhdim, Auditimi i Brendshëm kërkon nga Komiteti i Auditimit dhe Sekretari i Përhershëm i Kuvendit që të miratoj këtë dokument i cili rregullon raportet ndërmjet Auditimit të Brendshëm dhe pjesës tjetër të menaxhmentit funksional operativ.


Andaj Auditimi i Brendshëm paraqet para Jush këtë Statut të Auditimit të Brendshëm për miratim nga:



\_\_\_\_\_  
Sekretari i Përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës



\_\_\_\_\_  
Kryesuesi i Komitetit të Auditimit



\_\_\_\_\_  
Drejtori i Auditimit të Brendshëm

Data: 16.09.2011